

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Lumni Sallauka, kryetar i kolegjit, Rafet Haxhaj dhe Burim Shala, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit G.L. nga Peja, rr.“...”, ndërtesa ..., Hyrja, të cilin e përfaqëson me autorizim av. H.N. nga Peja, kundër të paditurës Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, PTK sh.a. Njësiti i Valës, me seli në Prishtinë, e përfaqësuar nga L.S., me objekt të padisë kompensimin e dëmit material nga marrëdhënia e punës, duke vendosur sipas ankesës së paditësit të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë C.nr.350/13, të datës 25.11.2014, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë **26.11.2018**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e paditësit G.L. nga Peja, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë C.nr.350/13, i datës 25.11.2014, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar C.nr.350/13, i datës 25.11.2014, në pjesën e parë të dispozitivit e ka refuzuar në terësi kërkesëpadinë e paditësit G.L. nga Peja, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura PTK Prishtinë, Departamenti i Valës-Njësia Vala-Post Paid në Pejë, që në emër të diferencës së pagave të papaguara në mes të vendit të punës shitës në Teleshop dhe vendit të punës Udhëheqës i Ekipit Post Paid, për periudhën kohore prej 01.10.2010 e deri me 30.04.2013, t’u paguajë shumën e terësishme (bruto) prej 14.994,67 euro, poashtu të detyrohet e paditura që në emër të kamatës së llogaritur nga eksperti financiar për periudhën e mësipërme kohore, paditësit t’i kompensohet shuma prej 1.067,24 euro si dhe të detyrohet e paditura që paditësit t’i paguajë shpenzimet e procedurës në lartësi prej 590 euro, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së aktgjykimit. Me pjesën e fundit të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka parashtruar ankesë paditësi përmes të autorizuarit të tij, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar, aktgjykimi i atakuar të ndryshohet ashtu që kërkesëpadia e paditësit të miratohet si e bazuar, ose i njejtë të prishet dhe çështja t’i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

E paditura nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesat e paditësit është **e pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me datë 25.04.2013, në Gjykatën Themelore në Pejë, paditësi G.L., ka paraqitur padi (të precizuar me parashtresën e datës 21.08.2014), kundër të paditurës PTK Prishtinë, Departamenti i Valës-Njësia Vala-Post Paid-Pejë, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që në emër të diferencave të pagave të papaguara në mes të vendit të punës shitës në Teleshop dhe vendit të punës Udhëheqës i Ekipit Post Paid, për periudhën kohore prej 01.10.2010, e deri me 30.04.2013, t'a paguajë shumën e terësishme prej 14.994,67 euro, në emër të kamatës së llogaritur nga eksperti financiar për periudhën e mësipërme, e paditura t'i kompensoj paditësit shumën prej 1.067,24 euro, si dhe duke i kërkuar shpenzimet e procedurës në lartësi prej 590 euro.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse, si në vijim: kontrata nr.01-2560-1478/05, e datës 20.10.2005, lista e pagesës e muajit dhjetor 2008, aktvendimi nr.5017/2010, i datës 04.10.2010, kontrata e punës nr.01-2880-1257/2011, e datës 20.10.2011, lista e pagesës së muajit shkurt e vitit 2011, parashtresa e datës 16.11.2012 me dorëshkrim e titulluar ankesë, vendimi nr.01-5850/2012, e datës 17.12.2012, parashtresa e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, e datës 06.12.2011, procesverbali nr.49 i mbledhjes së bordit të PTK-së, i datës 13.12.2011, vendimi i datës 07.12.2011, kërkesa e datës 13.12.2012, kërkesa e datës 28.06.2012, ekspertiza financiare, e datës 30.04.2014, e punuar nga eksperti financiar U.S., deklaratimet e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, si dhe pas vlerësimit të këtyre provave dhe të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.350/13, të datës 25.11.2014, me të cilën e ka refuzuar në terësi kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, ka theksuar se nuk është kontestues fakti që paditësi në cilësi të punëmarrësit ka themeluar marrëdhënie juridike të punës me të paditurën në cilësi të punëdhënëses, me detyra të punës në vendin e punës si shitës në Teleshop, në njesinë e Postës së Kosovës në lokacionin në Pejë, si dhe faktin se palët kontraktuese janë marrë vesh për pagesë mujore sipas gradës 6, sipas vendimit të Bordit të Përkohshëm të Drejtorëve të PTK-së, poashtu nuk është kontestues fakti se e paditura e sistemon paditësin në vendin e punës Udhëheqës i ekipit Post Paid Vala PTK sh.a. në Pejë, lidhur me këtë paditësi dhe e paditura krijojnë marrëdhënie pune dhe në bazë të kontratës respektivisht me nenin 2 parashihet se paditësi do t'i kryejë detyrat e punës në vendin e punës si Udhëheqës i Ekipit Post-Paid, ndërsa me nenin 5 të po të njëjtës kontratë, palët kontraktuese janë marrë vesh për pagën mujore sipas gradës 6, një gjë e tillë vërtetohet nga kontrata e punës me nr.01-2880-1257/11, e datës 20.10.2011. Më tutje ka shtuar se duke vendosur lidhur me bazën juridike të kërkesëpadisë është bazuar në dispozitat e nenit 10.1, 2, pika 2.1, 10.3, 10.5, 11, 55, 56 të Ligjit të Punës, e lidhur me nenin 5 të Kontratës së punës. Ndërsa lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata e shkallës së parë ka vepruar duke u mbështetur në dispozitat e nenit 463 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu ky aktgjykim nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për shkeljet që i referohen konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, pasi që arsyetimi i aktgjykimit është në përputhje me dispozitën e nenit 160 paragrafi 4 dhe 5 i LPK-së, meqë gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme për faktet e çështjes, për provat të cilat i ka shfrytëzuar për vërtetimin e fakteve dhe për vlerësimin e tyre. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre. Gjykata në arsyetim të aktgjykimit ka paraqitur arsye të mjaftueshme në lidhje me lëndimin dhe pasojat për paditësit, si dhe ka dhënë arsye të mjaftueshme për shumat e refuzuara, për dëmin material të kërkuara nga paditësi. Në të drejtim, Gjykata e Apelit e pranon në tërësi qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë në lidhje me bazën juridike të kërkesëpadisë së paditësit.

Gjykata e Apelit vlerëson se në kuptim të dispozitave materialo-juridike të cilave u është referuar gjykata e shkallës së parë e në përputhje me gjendjen faktike, duke marrë në konsideratë kontratën e punës nr.01-2880-1257/11, datë 20.10.2011, të lidhur në mes të paditësit dhe të paditurës, e cila në mënyrë të qartë dhe të plotë përcakton me anë të nenit 5, se paga e paditësit do të jetë në lartësi të gradës 6, ndërsa edhe me vendimin për risistemimin e punëtorit nr.5017/2010, datë 04.10.2010, në pikën III të tij ka përcaktuar se të ardhurat personale të paditësit mbesin në nivelin ekzistues, si dhe rrethanat tjera, rezulton se shumat e kërkuar nga paditësi në emër të kompensimit të pagave të papaguara gjatë kohës së risistemimit në vendin e punës për paditësin janë të pabazuara. Gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë dhe duke u bazuar në provat që i janë ofruar nga palët ndërgjyqëse, duke provuar se paditësit nuk i është bërë ndonjë e padrejtë, pasi që i njëjti ka qenë në dijeni me kushtet e kontratës dhe në mënyrë të ligjshme duke shprehur vullnetin e tij, ka lidhur kontratë me të paditurën, duke i pranuar kushtet dhe detyrat që dalin nga kontrata, si dhe njëherit është pajtuar edhe për lartësinë e pagës të cilën siç u cek më lartë e përcakton specifikisht neni 5 i kontratës së punës të cekur më lartë.

Gjykata e Apelit nuk e ka pranuar pretendimin ankimor të paditësit së gjykata e shkallës së parë ka bërë zbatim të gabuar të së drejtës materiale, pasi gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme, duke u bazuar në Ligjin e Punës të Kosovës dhe Kontratën e lidhur në mes të paditësit dhe të paditurës, ka vepruar drejtë kur ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar. Gjykata e shkallës së parë në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar, drejtë ka zbatuar edhe të drejtën materiale nga fakti se në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet ligjore që paditësit ti njihet e drejta e kompensimit të diferencës së pagës së punës shitës në Teleshop dhe vendit të punës Udhëheqës i Ekipit Post Paid. Në këtë drejtim, sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së dytë, në rastin konkret mungon baza juridike për pagesën e diferencës së pagës, për faktin se paditësi me nënshkrimin e kontratës me të paditurën, vetë është pajtuar edhe me lartësinë e pagës.

Gjykata e Apelit i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti së gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.322/15, datë 26.11.2018

**Kryetari i kolegjit,
Lumni Sallauka, d.v**